



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 29.01.2024
Ref. KM-50/24

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 2, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenet 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.7/ 01 mars 2019), bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2021) dhe nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11. Shtojcën I pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

- KËRKOHET**, lirimi i pronës publike Njësia Kadastrale P-71914059-02916-21, Fleta Poseduese 2478 Parcela Kadastrale 2916 Prishtinë, me sipërfaqe prej 0,55 ari nga N.T.SH. "LIRIA FC" Rruga Magjistrale Prishtinë-Fushë Kosovës - Zona Industriale, në pajtim me nenin 2 të Kontratës për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore e datës 10.02.2023, me numër të protokollit 518.
- Lirimi i pronës do të bëhet me datën 1 shkurt 2024, duke filluar në ora 12,00 h.
- Lirimi i pronës do të zbatohet ndaj shfrytëzuesit të hapësirës publike N.T.SH. "LIRIA FC", me numër të biznesit 80457839, të cilin e përfaqëson drejtori z. Fazli Cakiqi.
- Lënda e lirimit të pronës është lirimi nga njerëzit dhe sendet, nga shfrytëzimi i hapësirës publike sipas Fleta Poseduese 2478 Parcela Kadastrale 2916 Prishtinë, me sipërfaqe prej 0,55 ari, e cila gjendet në Zonën Industriale Prishtinë – Fushë Kosovës, pronë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Ekzekutimi i vendimit do të bëhet nga personat dhe organet kompetente të autorizuar të

- Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe me asistimin e Policisë Drejtorisë së Inspektimeve në Komunën e Prishtinës.
4. Gjatë ekzekutimit zyrtarët kompetent do të bëjnë regjistrimin e inventarit – mallit dhe i njëjti do të deponohet në hapësira përkatëse.
 5. Pas përfundimit të regjistrimit të investarit të gjetur në hapësirën publike si më lartë, zyrtarët kompetent të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, do e bëjnë ndërrimin e cilindrit mbyllës të dymit të hyrjes dhe do behet mbyllja e tyre.
 6. Nëse N.T.SH. "LIRIA FC" vetë e liron hapësirën publike në fjalë, atëherë organet kompetente do të pezullojnë procedurën e lirimit të pronës.
 7. Shpenzimet e lirimit të pronës publike bien në ngarkesë të N.T.SH. "LIRIA FC".
 8. Mjeti juridik i paraqitur kundër këtij Vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

Ar sy e t i m

Më datë 10.02.2023 është lidhur Kontrata për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore, me numër të protokollit 518, Njësia Kadastrale P-71914059-02916-21 sipas Fletës Poseduese 2478 Parcela Kadastrale 2916, me sipërfaqe prej 0,55 ari të lidhur në mes të MBPZHR dhe N.T.SH. "LIRIA FC". Në bazë të nenit 2 të kësaj kontrate, kohëzgjatja e kontratës ka qenë në kohë të caktuar për gjashtë (6) muaj dhe atë nga data 01.01.2023 deri më datë 30.06.2023. Pra, N.T.SH. "LIRIA FC" nga data 01.01.2024 është dashur ta liroj pronën në fjalë nga njerëzit dhe sendit për shkak se i ka skaduar kontrata. Për lirim të kësaj prone brenda afatit N.T.SH. "LIRIA FC" është njoftuar katër (4) herë, dhe atë përmes shkresës së datës 13.07.2023, 10.10.2023, 13.12.2023, dhe shkresës së datës 09.01.2024, mirëpo i njëjti nuk ka vepruar konform detyrimeve të tij kontraktuale dhe ligjore dhe nuk i ka marrë parasysh njoftimet-paralajmërimet e dhëna përmes këtyre shkresave. Duke qenë se N.T.SH. "LIRIA FC" nuk ka vepruar sipas nenit 2, të Kontratës për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore dhe detyrimeve që i ka në bazë të nenit 602, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, MBPZHR më datë 09.01.2024 i ka dërguar N.T.SH. "LIRIA FC" shkresën me numër nr. 68, paralajmërimi i fundit për mos përmbushje të obligimeve kontraktuale dhe paralajmërim për lirim të pronës, mirëpo N.T.SH. "LIRIA FC" nuk ka vepruar sipas kësaj shkrese. Pra, MBPZHR që katër (4) herë radhazi kërkon prej N.T.SH. "LIRIA FC" që ta liroj pronën vullnetarisht konform nenit 2 të kontratës, mirëpo i njëjti nuk e ka bërë një gjë të tillë. N.T.SH. "LIRIA FC" nuk ka bazë ligjore për ta mbajtur këtë pronë, andaj i njëjti nga data 01.01.2024 e mbanë kundërligjshëm pronën në fjalë.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në nenin 2, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenet 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.7/ 01 mars 2019), nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2021), citohet: "*Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe: 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: administrativ individual), gjegjësisht "kolektiv", apo 1.2. i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme (në vijim: "akti administrativ i përgjithshëm"), apo 1.3. përcakton statusin sipas të së drejtës administrative të një objekti (sendi) apo të përdorimit të tij nga publiku (në vijim: "akti administrativ in rem"), si dhe duke u bazuar në nenin 2, të Kontratës për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore dhe detyrimeve që i ka në bazë të nenit 602, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve,*

vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mjeti juridik nuk e ndal ekzekutimin e këtij konkluzioni.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë për parashtrimin e mjetit juridik, për konflikt administrativ në Gjykatën kompetente për çështje administrative në afat prej 30 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

Faton PEÇI
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Vendimi i dërgohet:

- N.T.SH. "LIRIA FC". - përfaqësuar nga Fazli Cakiqi,
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike,
- Kabinetit të Ministrisë,
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
- Inspektionit të Komunës së Prishtinës, dhe
- Arkivit;